



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700388/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë njohjen e derdhjes së sigurimit suplementar të punonjësve të Shërbimit Social Shtetëror sipas VKM-së nr.548 datë 27.07.2016 "Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".*

Drejtuar: Z. Astrit HADO
Drejtor i Përgjithshëm Institutit të Sigurimeve Shoqërore

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë shtetaset I.Sh, V.M dhe M.B, në përmbajtjen e së cilës ankohen për mosdhënien e së drejtës për të përfituar të plotë pensionin suplementar.

Sipas shpjegimeve të tyre, këto shtetase kanë qenë punonjëse pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe aktualisht janë përfituese të pensionit të pleqërisë. Dy nga këto punonjëse kanë filluar punë që në vitin 1992 pranë Administratës së Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale, sot Shërbimi Social Shtetëror. Me mbushjen e moshës për pension pleqërie, kanë dorëzuar dokumentacionin pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Nga ana e asaj drejtorie i është lidhur pensioni i pleqërisë si dhe pensioni suplementar, por pensioni suplementar nuk i jepet për të gjitha vitet që kanë derdhur sigurim suplementar (1992-2015, 1992-2016), por i njihen vetëm periudha 1992-2002. Kjo për arsyen se me VKM nr.153 datë 25.04.2002 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror", Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale iu ndryshua emërtimi, në Shërbimin Social Shtetëror.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 548 datë 27.07.2016 "Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", në pikën 8 të tij ka përcaktuar se:

"8. Personave të punësuar në institucionet qendrore buxhetore, të cilët kanë paguar kontribute suplementare, pavarësisht ndryshimit të emërimit të institucionit, e gjithë periudha për të cilën janë derdhur kontribute do t'u njihet si vjetërsi shërbimi.."

Derdhja e sigurimit suplementar konfirmohet me shkresën nr. 1755/1 datë 17.03.2017 të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Në këtë shkresë thuhet shprehimisht se:

"...Shërbimi Social Shtetëror ka derdhur kontribute për punonjësit në skemën suplementare edhe pas ndryshimit të emërimit të institucionit, pra pas vitit 2002 e në vazhdim.

Mendojmë se për zgjidhjen e këtij problemi ISSH duhet të bazohet në pikën 8 të VKM nr.548 datë 27.07.2016...."

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Njohjen e derdhjes së sigurimit suplementar të punonjësve të Shërbimit Social Shtetëror sipas VKM-së nr.548 datë 27.07.2016 "Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", me qëllim përfitimin e plotë të pensionit suplementar.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit", lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI

